

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë"

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Nëpërmjet Urdhrit nr.13, datë 13.11.2023, të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është ngritur Grupit Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" me anëtarë nga kabineti i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare të Rinisë.

Procesi i konsultimeve për ndryshime në Ligjin 75/2019 “Për Rininë” ka filluar gjatë periudhës Janar-Nëntor 2024 dhe ka përfshirë turin e konsultimit të zhvilluar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës me aktorët e jashtëm si organizata të shoqërisë civile, rrjete dhe organizata rinore, të rinj përmes takimeve të posaçme fizike, takimeve online dhe emailit.

Projektligji për “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe ka zgjatur në datat 27.11.2024-25.12.2024.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801>

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, përfshijnë:

1. Konsultime fizike dhe online me aktorët e synuar dhe grupet e interesit për ndërmarrjen e vlerësimit ex post të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, dhe akteve nënligjore dhe përgatitjes së propozimeve ligjore bazuar në vlerësimin e nevojave, synimeve, prioritetëve dhe propozimeve të aktorëve shoqëror ku përfshihen:
 - Gjatë muajit qershor 2024 u zhvillua një workshop-i për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”. Gjatë këtij aktiviteti u angazhuan mbi 80 përfaqësues nga institucionet shtetërore

qendrore dhe vendore, përfaqësuesve të organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), rinore dhe për të rinjtë, këshillit kombëtar të rinisë, këshillave vendore rinore, të organizatave rinore ombrellë, këshillave studentorë, të organizatave donatore/partnerëve për zhvillim në sektorin e rinisë dhe ekspertëve dhe studiuesve në fushën e rinisë që u angazhuan në diskutimin e hapur dhe të strukturuar lidhur me arritjet, problematikat dhe nevojat për rishikimin e Ligjit për Rininë. Për marrjen e kontributeve në mënyrë efektive, workshop-i u konceptua në formën e katër tryezave të veçanta të punës që trajtuan aspektet e ligjit të grupuara sipas katër temave:

- Kompetencat, funksionet dhe angazhimi i institucioneve shtetërore në fushën e rinisë.
 - Organizimi dhe veprimtaria e strukturave dhe organizatave me të rinjë.
 - Financimet për rininë
 - Krijimi i kushteve për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve.
- Gjatë muajit korrik 2024 u zhvillua turi i konsultimeve me të rinjtë **“Rinia ndryshon ligjet”**, në 12 bashki të vendit, përkatësisht Kurbin, Kamëz, Shkodër, Lushnjë, Kuçovë, Dibër, Durrës, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Konispol, dhe Korçë. Me qëllim lehtësimin e marrjes së kontributeve nga të rinjtë u përgatitën materialet informuese dhe pyetësorët për të dy ligjet në version elektronik, të cilat ju prezantuan atyre përmes platformës Kahoot.
 - Takime konsultuese fizike dhe online me përfaqësuesit e 48 organizatave jofitimprurëse rinore dhe/ose për të rinjtë.
 - Zhvillimi i Bootcampit më datë 29-31 Korrik 2024, gjatë të cilit anëtarët e KVR-ve diskutuan lidhur me propozimet e tyre për Ligjin për Rininë.
 - Grupi i Punës është mbledhur tre herë gjatë periudhës së tretë të raportimit dhe puna ka qenë e fokusuar kryesisht në zbardhjen dhe përpunimin të dhënave dhe rekomandimeve pas zhvillimit turit të konsultimeve me të rinjtë, workshopit me organizatave të shoqërisë civile dhe rekomandimet e përcjella pranë MSHRF nga aktorë të ndryshëm shoqëror gjatë kësaj periudhe.
2. Konsultime përmes emailit, ku aktorët e shoqërisë civile patën mundësinë të dërgonin propozimet e tyre tek anëtarët e grupit të punës.
 3. Konsultime përmes REJNK, në datat 27.11.2024-25.12.2024.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801>

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilat kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

1. Mbi 48 organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fusha të ndryshme kanë marrë pjesë në konsultimet fizike/online ose kanë përcjellë rekomandimet e tyre përmes postës elektronike dhe regjistrimit elektronik;
2. Mbi 480 të rinj, anëtarë të KVR-ve, KKR-së, studentë dhe punonjës rinore kanë dhënë rekomandimeve përmes turit të konsultimeve me të rinjtë dhe takimeve të tjera.
3. Ekspertë të mbështetur nga projekte të UNICEF dhe UNOPS.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
1. Cili është objekti i këtij ligji?	1. Përfshirja e statusit të të rinjve në diasporë në mënyrë më të detajuar (Neni 1) Rekomandim: Të shtohet një paragraf i ri si vijon: a. "Ky ligj garanton mbrojtjen e veçantë për të rinjtë në diasporë, duke specifikuar të drejtat, detyrimet dhe mbështetjen që ata duhet të marrin nga shteti shqiptar." Argument: Ligji duhet të shpjegojë qartë sesi shteti do të garantojë mbrojtjen e veçantë për të rinjtë në diasporë sipas Nenit 54 të Kushtetutës (Rekomandimet nga Asambleja e KRK 2019, Neni 1).	1. KRK/Asamble	1. I pranuar pjesërisht.	1.Në projektligj janë parashikuar masa për përfshirjen e të rinjve nga diaspora në proceset vendimmarrëse
2. Antarësimi në KVR.	2. Sugjerim: KVR mund të përfaqësohet nga një anëtar i përzgjedhur mes anëtarëve të tij me shumicë votash. Kryetari i bashkisë duhet të jetë një anëtar i KVR i cili dëgjon të rinjtë dhe dërgon çështjet e tyre në Këshillin Bashkiak. Argument: KVR duhet të jetë një strukturë e pavaruar politikisht që operon pranë Kryetarit të Bashkisë dhe jo nën drejtimin e tij. Për të krijuar një strukturë më autonome në vendimarrje dhe për të adresuar problematikat e përmendura	2.OSHC rinore/për të rinjtë ;KRK+Asamble; të rinjtë	2.I pranuar pjesërisht	2. Projektligji propozon konceptin e “bashkëkryesimit” të KKR KVR. Gjithashtu, është propozuar rritja e përfaqësimit të garantuar për të rinjtë brenda strukturave konsultative rinore, si Këshilli Kombëtar i

3.Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore	lidhur me anëtarësinë e organizatave rinore. 3. Neni 13 i ligjit Nr. 75/2019 të përditësohet duke i shtuar një opsion si vijon: . Të drejtën për të zgjedhur Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate, të rregulluara në statutin e saj. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore duhet të ketë përfaqësi në të paktën 12 njësitë administrative të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të kryejë funksionin e saj në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore rekomandohet të jetë pjesë e strukturave rinore ndërkombëtare me njohje dhe legjitimitet të gjerë, duke siguruar që organizata të ketë përvojë dhe njohuri ndërkombëtare dhe të ketë një platformë përfaqësimi. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore duhet të ketë një histori të dëshmuar të përfshirjes aktive dhe	3.OSHC rinore/për të rinjtë ; të rinjtë	3.Refuzuar	Rinisë dhe Këshillin Vendor të Rinisë nga një e dyta që është aktualisht, në dy të tretat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. 3.Kriteret për përzgjedhjen e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore nuk mund të jenë kufizuese.
--	---	--	-------------------	---

	efektive në politikat rinore dhe të jetë e njohur nga organizatat rinore dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për angazhimin dhe rezultatet e saj. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore duhet të ketë kapacitetet dhe resurset e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e saj, duke përfshirë burime njerëzore të kualifikuara dhe një strukturë organizative të mirëpërcaktuar. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore duhet të përfaqësojë një gamë të gjerë organizatash rinore me përvojë dhe diversitet në aktivitete, për të siguruar një përfaqësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të interesave rinore. Kriteret për përzgjedhjen e organizatave anëtare dhe mënyra e funksionimit të Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore do të përcaktohen me akte nënligjore."			
4. Punonjësi Rinor	4. Specifikimi i termit punonjës rinor Rekomandim: Punonjës rinor është zbatues i punës rinore që “ofron mbështetje dhe orientim për të rinjtë në një sërë fushash, përfshirë arsimin, karrierën, jetën sociale, kulturore, mjedisore dhe më shumë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. se kush është ai/a jo që jep këtë shërbim për të rinjtë.	4.OSHC rinore/për të rinjtë ; të rinjtë <i>*Përkufizim i ofruar nga ekspertët e studimit ‘Dimensione rinore: potenciali dhe zhvillimi i punës rinore në Shqipëri, studim kombëtar mbi punë rinore’, bere nga Pertej</i>	4.Pranuar	4.Në projektligjin e propozuar është përcaktuar koncepti i punonjësit rinor dhe mekanizmat që mbështesin ngritjen e programeve për formimin profesional të tyre.

5. NEET dhe grupe të tjera.	5. Të përfshihet në ligj edhe përkufizimi dhe referenca për termin <i>NEETs</i>.	<i>Barrierave dhe KRK</i> 5. UNICEF/UND P	5.Pranuar	5. Reflektuar në nenin 3 të projektligjit të propozuar
6. Neni 15 Burimet e financimi	6. Duhet zgjeruar parashikimi i autorizimit ligjor, percaktuar në pikën 3 të nenit 15 për të përfshirë kriteret e perzgjedhjes së projekteve të infrastrukturës rinore nga NJVV-të dhe eventualisht çdo kategori tjetër përfituesi i grantit rinor, nëse shtohen. Sugjerohet shtimi i pikës 3: Kriteret dhe procedurat e perzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë dhe grupeve joformale rinore, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përveç financimit nëpërmjet fondeve grant për rininë, aktivitetet dhe infrastruktura rinore si qendrat rinore duhet të planifikohen e parashikohen në buxhetet vendore në mënyrë të fokusuar, duke ndjekur praktikën e suksesshme të buxhetimit me bazë gjinore që zbatohet nga të gjitha bashkitë. Në nenin 15 të ligjit – Burimet e Financimit në pikën 1 për burimet e financimit pika “b” të ndryshohet si vijon:	6. <i>Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD)</i>	6.Refuzuar	6. Vendosja e detyrimeve buxhetore nuk është objekt i këtij ligji, kërkesa të integrohet brenda kuadrit ligjor që rregullon planifikimin dhe menaxhimin e financave publike në nivel qendror dhe vendor, duke siguruar vendosjen e programeve/treguesve/produnkteve për rininë dhe parashikimin e fondeve të nevojshme buxhetore për realizimin e tyre. Nëse do i referohemi praktikës së buxhetimit gjinor, parshikimi i kërkesave ligjore është

	<i>Buxhetet vendore të fokusuara për rininë sipas kërkesave nga procesi i buxhetimit me pjesëmarrje.</i> Pika “dh” e këtij neni të ndryshohet si vijon: <i>Burime të tjera të ligjshme bazuar edhe në veprimtaritë ekonomike të organizatave rinore dhe për të rinjtë që financojnë qëllimin jofitimprurës të strukturave rinore.</i>			realizuar tek: Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, neni 4, germa e); Udhëzimin për Përgatitjen e Buxhetit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, Aneksi 5 “Buxheti i Përgjigjshëm Gjinnor”.
7. Neni 16 i Financimi politikave, programeve dhe projekteve rinore	7. Agjencia Kombëtare e Rinisë duhet të bëjë transparencë të plotë të procesit të grantimit të organizatave dhe bashkive duke publikuar fondin total, skemën, kriteret dhe bordin vlerësues, numrin total të aplikantëve, shumën dhe natyrën e projektit për secilin përfitues. AKR duhet të lehtësojë procedurat e aplikimit për grante për organizatat rinore dhe për të rinjtë dhe të përzgjedhë një periudhë më të përshtatshme për shpalljen e thirrjes.	<i>7. Studim Sfidat dhe Efektet e Zbatimit të Ligjit të Rinisë, Këshilli Rinor Kombëtar 2021</i>	7. Refuzuar	7. Rregullat dhe kriteret për zhvillimin e procedurave konkurruese për financimin përmes grantit shtetëror të rinisë, të projektpropozimeve me ndikim tek të rinjtë, të paraqitura nga organizatat rinore dhe për të rinjtë, si dhe të projektpropozimeve të

				paraqitura nga bashkitë, për ndërtimin/rikonstruksionin e infrastrukturës rinore janë të parashikuara në VKM nr. 566, datë 29.07.2022.
	7.1 Rishikimi i legjislacionit për të Rinjtë, Vlerësim dhe rekomandime për ndryshime në Ligjin për Rininë, dhjetor 2023: Eshtë e domosdoshme të përfshihet koncepti i buxheteve të dedikuara për të rinjtë, në nivel qendror dhe vendor. Kjo do të thotë që në hartimin e planifikimin e buxhetit të shtetit dhe politikave të tjera financiare, duhet të kushtohet një vëmendje e dedikuar për sigurimin e burimeve të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur zhvillimin dhe mirëqenien e të rinjve bazuar në praktikën tashmë të suksesshme të buxhetimit gjinor, i cili zbatohet me sukses aktualisht në Shqipëri.		7.1 Refuzuar	Vendosja e detyrimeve buxhetore nuk është objekt i këtij ligji, kërkesa të integrohet brenda kuadrit ligjor që rregullon planifikimin dhe menaxhimin e financave publike në nivel qendror dhe vendor.
8. Neni 17 Infrastruktur a rinore	8. Rishikimi i legjislacionit për të Rinjtë, Vlerësim dhe rekomandime për ndryshime në Ligjin për Rininë, dhjetor 2023: Hapësira rinore të sigurt Është e nevojshme që ndryshimet në ligjin për rininë të zhvillojnë më tej konceptin e hapësirave të shërbimeve miqësore për të rinjtë dhe të	<i>8. Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD)</i>	8. Pranuar	8. Në projektligjin e propozuar është shtuar pika 17/1 e cila përcakton ngritjen e qendrave rinore,

9 . Puna Rinore	hapësirave të sigurta duke vendosur kriteret dhe ofruar standarde të matshme për të vlerësuar përmbushjen e këtij standardi. Ndërsa këta janë aspekte shumë teknike për t'u përfshirë në ligjin për rininë, është e rekomandueshme që këto të rregullohen me akte nënligjore. Duke qenë se për miratimin e standardeve të hapësirave të sigurta për të rinjtë nevojitet dhe përfshirja e ministrisë përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe ministrive përgjegjëse për arsimin dhe arsimin e formimin profesional në lidhje me infrastrukturën e shkollave të arsimit të përgjithshëm e profesional si edhe qendrave profesionale, është e rekomandueshme që ndryshimet në ligjin për rininë të parashikojnë një dispozitë autorizuese që kriteret dhe standardet për hapësirat e sigurta për të rinjtë të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 17 i ligjit për rininë të fillojë me një pikë të re shtesë që bëhet pika 1 me një përmbajtje të ngjashme me pikën 1 të nenit 17 të draft-ligjit për rininë të Republikës së Kosovës. Për të siguruar infrastrukturë të sigurtë rinore si fizike dhe digjitale rekomandohet edhe shtimi i një pike të re në nenin 17 e cila kërkon rregullimin me akt nënligjor të standardeve për hapësira të sigurtë rinore në përputhje me masat e parashikuara në Strategjinë për Rininë 2022-2029 dhe në përputhje me dispozitat europiane për krijimin e hapësirave të sigurta rinore.	9. <i>Fondacionit Westminster për</i>	9. Pranuar	mënyrën e financimit etj. Struktura, roli, funksionet, mënyra e administrimit dhe standardet bazë të cilësisë të qendrave rinore do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rininë dhe ministrit përgjegjës për çështjet vendore, dhe zbatohen për qendrat rinore në pronësi publike dhe private. 9. Projektligji propozon shtimin e nenit
-------------------------------	--	--	-------------------	---

	Ligji aktual nuk parashikon rregullime dhe as përkufizim për punonjës të rinor. Përmes ligjit të ri, Këshilli Kombëtar i Rinisë propozon përfshirjen e një përkufizimi të punonjës të rinor, të ngjashëm me përkufizimin e Erasmus+. Propozohen rishikimet në Ligj: Në nenin 3, shtohen gjerat f) dhe g) me këtë përmbajtje: a) “Puna rinore” konsiderohet çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi b) “Punonjës Rinor” është çdo individ i cili punon vullnetarisht apo me pagesë me të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç me qëllim zhvillimin personal, profesional dhe social të tyre përmes ofrimit të shërbimeve edukative, kujdesit dhe argëtimit në mjedise joformale. Në nenin 14, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: Punonjësi rinor është çdo individ i cili punon vullnetarisht apo me pagesë me të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç me qëllim zhvillimin personal, profesional dhe social të tyre përmes ofrimit të shërbimeve edukative, kujdesit dhe argëtimit në mjedise joformale. Rekomandim: Me zhvillimin e konceptit të punonjës të rinor me rastin e ndryshimeve në ligjin për rininë dhe konsolidimit të praktikës së punës rinore në Shqipëri, do të unifikohet termi për këtë profesion	Demokraci (WFD)		14/1 që prezanton konceptin punonjës të rinor dhe ofron rregullime me qëllim standardizimin e këtij profesioni, përcaktimit të kompetencave që duhet të zotërojnë punonjësit rinorë, si dhe nxitjes dhe lehtësimit të ngritjes së programeve për formimin e punonjësve rinorë dhe kualifikimin e vazhduar të tyre.
--	--	-----------------	--	---

	dhe duhet të rishikohet përshkrimi i tij, në përputhje me qëllimin e misionin. Rregullimet për punonjësin rinor kontribuojnë në forcimin e sektorit të rinisë pasi ka shumë njerëz që punojnë me të rinj në kontekstin joformal dhe informal, por nuk mund të identifikohen, njihen dhe certifikohen si të tillë. Rekomandim: Rregulli i statusit të punonjësit rinor do të ngërthejë aspekte sa teknike dhe politikë-bërëse të cilat e kalojnë hapësirën e ligjit për rininë. Është e rekomandueshme që këto të rregullohen me akte nënligjore në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet që kanë ndodhur nga vënia në zbatim e SKR-së në lidhje me angazhimet e të rinjve jashtë orarit mësimor si në procese sportive, argëtuese dhe të zejtarisë. Rekomandim: Për këtë çështje ka praktika të mira të cilave mund t'i referohemi në lidhje me njohjen e punës rinore, format dhe standardet e cilësisë që duhet të zbatohen, si në rastin e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, dhe në përputhje me European Youth Work Portfolio etj. • Të konsolidohet në tërësi kuadri ligjor/rregullator për institucionalizimin e punës rinore, njohjen/standardizimin e profesionit dhe kompetencat që duhet të ketë punonjësi rinor dhe sigurimin e cilësisë. Ky kuadër duhet të përfshijë edhe kodin e etikës për punonjësit rinorë, udhëzime për formimin dhe kualifikimin si dhe sistemin e monitorimit nga institucionet publike përkatëse për sigurimin e cilësisë. • Njohja e kompetencave përfituar nga edukimi joformal dhe			
--	--	--	--	--

	puna rinore të bazohen në ligjet dhe VKM-të përkatëse. Fuqizimi i kapaciteteve të nëpunësve civile në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore.			
10. Baza e të dhënave për rininë	10. Në nenin 18 Baza e të dhënave për rininë, ndryshohet germa a) e pikës 2 me këtë përmbajtje: a) të dhënat parësore, që kanë të bëjnë me organizata rinore dhe për të rinjtë dhe grupe joformale rinore në vend dhe në diasporë, Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore, politikat rinore kombëtare, vendore dhe europiane;	10. <i>Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD)</i>	10. Pranuar	10. Në projektligj janë shtuar fjalët... “grupet joformale rinore...”
11. Organizatat rinore	11. Neni 22 Organizatat rinore Organizatë rinore do të konsiderohen organizatat joqeveritare të njohura dhe të regjistruara sipas Ligjit për Organizatat Jofitimprurëse, që kryejnë punë rinore ose organizojnë aktivitete për të rinjtë, ku të paktën 70% e pjesëmarrësve dhe përfituesve, janë të rinj sipas përcaktimeve të këtij ligji.	11. <i>Propozime të ardhura nga konsultimet publike në Bashki</i>	11. Pranuar	11. Ndryshuar si vijon: të paktën, 70 për qind e anëtarëve, në rastin e organizatave me anëtarësi dhe të bordit të drejtorëve, në rastin e organizatave pa anëtarësi, të jenë të rinj.
12. Grupet joformale rinore	12. Njohja e Grupeve Joformale Rinore si formë e organizimit të të rinjve e financueshme nga fondi grant për rininë Shumica e grupeve joformale në Shqipëri janë të iniciuara nga të rinj dhe kanë kryesisht target grup përfitues të rinj. Në kushtet aktuale,	12. <i>Propozime të ardhura nga konsultimet publike në Bashki</i>	12. Pranuar pjesërisht	15. Është shtuar përkufizimi i termit “grup joformal rinor” si një formë më e thjeshtuar dhe me më pak barriera e

	me përjashtim të grupeve joformale rinore të iniciuara nga aktorë të huaj (YAG-OSBE, USEYCA-Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, YEA- Delegacioni European) grupet joformale rinore kanë mundësi jashtëzakonisht të limituara për të thithur financime nga donatorë të brendshëm, gjë e cila në afatgjatë ndikon negativisht në kapacitetet e tyre për të krijuar nisma me impakt si dhe për të fituar eksperiencë/për t'u formalizuar. Në kontekstin shqiptar, njohja e grupeve joformale rinore si grup përfitues i fondit grant për rininë do të kishte një sërë benefitesh ku përfshihen: 1. Nxitja e organizimit të të rinjve veçanërisht në Bashkitë më të vogla në Shqipëri ku ka mungesë të prezencës së organizatave rinore. 2. Mbështetja e grupeve joformale rinore ekzistuese për të rritur impaktin e tyre në komunitetet respektive (Shembull: Këshillat Studentorë tek studentët në Fakultetet respektive, etj) 3. Krijimi i kushteve që më shumë të rinj të përfshihen në punë rinore dhe të kontribuojnë direkt në realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Rinisë. Në ligjin e ri për Rininë rekomandojmë përkufizimin e grupeve joformale rinore duke përshtatur modelin e Erasmus+ si dhe duke marrë parasysh modelet e përfshirjes së grupeve joformale rinore në skemat e financimit si Tirana European Youth Capital 2022 dhe Projekti “Lëviz Albania”. Propozohen shtesat si vijon: Në nenin 3, pika e) “Grup joformal rinor” është grup i përbërë nga më shumë se 2 të rinj të grupmoshës 15-			organizimit rinor. Në nenin e shtuar përcaktohet koncepti i grupeve joformale rinore, kriteret që duhet të përmbushin, mënyrën e regjistrimit, format dhe burimet e financimit etj
--	---	--	--	--

13. Propozime të reja	29 vjeç të cilët zhvillojnë aktivitete dhe programe nuk kanë qëllim fitimin dhe që nuk janë të regjistruar si person juridik sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001“Për Organizatat Jofitimprurëse”. 13. 1.Në të gjithë tekstin e ligjit, fjala “të rinjtë” duhet të zëvendësohet me “të rejat dhe të rinjtë në të gjithë diversitetin e tyre”. Ky zëvendësim, së pari synon shkrimin e ligjit me gjuhë të ndjeshme gjinore, ku të rejat të mos jenë më të nënkuptuara brenda fjalës “të rinjtë”, por të evidentohen qartësisht si grup i mbrojtur dhe i trajtuar nga ky ligj sikurse edhe të rinjtë. Së dyti, përdorimi i togfjalëshit “në të gjithë diversitetin e tyre” harmonizon gjuhën e ligjit me gjuhën e përdorur në Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025 dhe në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore III të BE-së 2021-2025 (EU GAP III), si një togfjalësh që sjell në vëmendje që të rejat dhe të rinjtë janë edhe me aftësi të kufizuara, edhe nga minoritetet etnike, edhe nga zonat rurale, edhe nga komuniteti LGBTIQ+, etj., pra togfjalëshi jep qartësisht mesazhin e gjithëpërfshirjes dhe të përkatësisë së shumëfishtë (intersectionality) të këtij grupi të synuar që mbrohet me ligj. Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 është përdorur togfjalëshi “nga të gjitha grupet” gjatë harmonizimit të gjuhës me EU GAP III për “in all their diversity / në të gjithë diversitetin e tyre”). 2. Në të gjithë tekstin në ligj duhet të përdoren korrektësisht të dy	<i>13.Rekomandime të ardhura në fazën e konsultimeve publike nga organizata ndërkombëtare UN Women</i>	13. Refuzuar	13. Lidhur me sugjerimin për përdorimin e dy gjinive në projektligjin e propozuar, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6, datë 29.04.2022, “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, kur dispozitat ligjore u referohen njerëzve, format gramatikore mashkullore përdoren në mënyrë konvencionale të përgjithësuar (mashkullore përgjithësuese) duke përfshirë të dyja gjinitë. Teksti i legjislacionit, sugjerohet të hartohet me terminologji asnjëanëse përsa i përket
-------------------------------------	---	---	---------------------	--

	gjinitë. Kjo do të bëjë që gjuha e përdorur në shkrimin e ligjit të jetë e ndjeshme gjinore dhe të mos lihet jashtë vëmendjes asnjë grup në shoqëri, si për shkak të gjinisë ashtu edhe të karakteristikave të tjera individuale. (pra anëtarët/anëtarët; punonjëset/punonjësit; ministrja/ministri; kryetare/kryetar...etj.). 3.Kudo ku është e mundur të bëhet referencë në zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore dhe të parashikimeve për masa afirmative e kuota, për rritjen e përfaqësimit të barabartë ndërmjet të dy gjinive (kjo veçanërisht kur flitet për krijimin e këshillave rinorë apo organeve të tjera). 4. Kudo ku është e mundur dhe flitet për planifikim e hartim dokumentesh të politikave, të theksohet rëndësia e integritetit gjinor, analizës gjinore, vlerësimit të ndikimit gjinor, vendosjes së treguesve gjinorë, përdorimit të të dhënave të ndara sipas seksit e karakteristikave të tjera individuale, statistikave gjinore, si dhe aplikimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në planifikim, alokim, shpenzim e monitorim të burimeve financiare. 5. Kudo ku flitet për të dhëna, duhet të theksohet që të dhënat duhet të mbledhen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt (p.sh. çdo gjashtë muaj), të jenë të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera personale, si mosha, etnia, aftësia e kufizuar, vendbanimi, orientimi seksual e shprehja e identitetit gjinor, arsimimi, etj., klasifikime këto që duhet të përcaktohen në			gjinisë, duke përdorur tema me gjini asnjëanëse. Ligji për Rininë është hartuar duke ju përmbajtur rregullave të specifikuar më sipër. Në projektligj është parashikuar parimi i gjithëpërfshirjes, ku politikat rinore garantojnë pjesëmarrjen efektive dhe të barabartë në të gjitha sferat e jetës të të rinjve që i përkasin grupeve të marginalizuara, të rinjve me nevoja të veçanta, të rinjve me akses të kufizuar në shërbime dhe burime, dhe të rinjve neet.
--	--	--	--	---

	bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Statistikave (INSTAT). Gjithashtu, duhet të përdoren rregullisht edhe statistikat gjinore dhe treguesit gjinorë. 6. Riformulimi i pikës c) të nenit 3 në ligjin ekzistues. Riformulimi bëhet për dy qëllime kryesore” së pari, që të mos krijohet ideja që për të rejat dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara do ketë hapësira rinore të veçanta, por të jepet qartësisht mesazhi që çdo hapësirë rinore e sigurt duhet të përmbajë patjetër edhe të gjithë elementet e përshtatjes së arsyeshme. Së dyti, në “sigurinë” e hapësirës rinore duhet të merren masa për mbrojtje dhe siguri edhe nga të gjithë format e dhunës dhe abuzimit që të rejat dhe të rinjtë mund të ndeshen në hapësirat publike (p.sh. ngacmimi seksual, përndjekja, etj.), por edhe në hapësirat digjitale (dhuna kibernetike). 7. Shtimi i pikës g) në nenin 3 të ligjit ekzistues. Ky përkufizim shtohet për të qartësuar konceptin “të reja dhe të rinj në të gjithë diversitetin e tyre”, koncept që së pari është i ndjeshëm gjinor dhe së dyti merr në konsideratë dhe harmonizon terminologjinë edhe me atë të përdorur në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III) – (in all their diversity). 8. Riformulimi i pikës 1/a) të nenit 4 në ligjin ekzistues. Shtesat e propozuara synojnë të evidentojnë qartësisht shmangien e të gjithë formave të diskriminimit, përfshirë diskriminimin gjinor dhe për shkak të përkatësisë së shumëfishtë			
--	--	--	--	--

	(intersetional discrimination), koncepte këto që theksohet se duhet t'u jepet rëndësi e veçantë edhe në vërejtjet përmbyllëse që Komiteti CEDAË i dërgoi Shqipërisë në 25 tetor 2023. 9. Riformulimi i pikës 1/b) të nenit 4 në ligjin ekzistues. Barazia gjinore dhe drejtësia gjinore duhet të evidentohen qartësisht krahas mundësive të barabarta. Po këtu, është me rëndësi edhe shtimi i disa fushave për të cilat flasin edhe një sërë dokumentesh ndërkombëtarë të ratifikuar e që zbatohen nga shteti shqiptar si Konventa CEDAË, Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit, Agjenda 2030 dhe OZHQ-të, etj., pra konkretisht: arsimi profesional, udhëheqja, pjesëmarrja e barabartë dhe vendimmarrja politike e publike, transformimi digjital, fuqizimi ekonomik, parandalimi e mbrojtja nga të gjitha format e dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës me bazë gjinore, ekonomia e gjelbër (green economy), zvogëlimi i rrezikut ndaj fatkeqësive dhe qeverisja e përgjigjshme gjinore. 10. Plotësimi i pikës a) në nenin 5 të ligjit ekzistues. Shtimi i fjalëve “me perspektivën gjinore të integruar, si dhe “duke u bazuar në analizën gjinore dhe vlerësimin e ndikimit gjinor të tyre”, ka për qëllim sjelljen në vëmendje të plotësimit të detyrimit për legjislacion, strategji, politika, masa e veprime të ndjeshme gjinore, si dhe për hartimin e tyre bazuar në analizë gjinore dhe duke marrë në konsideratë vlerësimin e ndikimit gjinor të tyre.			
--	--	--	--	--

	11. Plotësimi i pikës b) në nenin 5 të ligjit ekzistues. Shtimi i fjalëve “alokon dhe shpenzon” bëhet për t’u siguruar që shpenzimet e planifikuara merren në konsideratë dhe realizohen sipas planifikimit. Ndërsa shtimi i fjalëve “përmes përdorimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, si dhe publikon rregullisht raportet mbi analizën gjinore të programeve buxhetore dhe shpenzimeve përkatëse” bëhet për t’u siguruar që ministria përkatëse plotëson detyrimet për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor sipas legjislacionit në fuqi. 12. Plotësimi i pikës ç) në nenin 5 të ligjit ekzistues. Shtimi në fund i togfjalëshit “përmes përmbushjes së treguesve gjinorë” bëhet për t’u siguruar që politikat dhe strategjitë, apo programet e projektet hartohen me tregues të ndjeshëm gjinorë dhe zbatimi i tyre monitorohet edhe përmes përmbushjes së këtyre treguesve gjinorë. 13. Plotësimi i pikës d) në nenin 5 të propozuar në projekt-ligj. Shtimi i fjalëve “sigurisë, aksesueshmërisë dhe barazisë gjinore” bëhet për t’u siguruar që këta elementë të domosdoshëm të përfshihen në atë çfarë përmbajnë standardet e “cilësisë”. 14. Plotësimi i pikës a) në nenin 6 të ligjit ekzistues. Shtimi i togfjalëshit “e të përgjigjshme gjinore” bëhet për t’u siguruar që perspektiva gjinore integrohet sipas kërkesave e legjislacionit në fuqi. Po kështu, shtimi i togfjalëshit “me tregues të përgjithshëm dhe tregues			
--	--	--	--	--

	gjinorë të mirë përcaktuar” bëhet për t’u siguruar që së pari politikat që kur hartohen përmbajnë tregues për matjen e zbatimit të tyre dhe së dyti që ndër treguesit që parashikohen duhet që të ketë patjetër edhe tregues gjinorë. 15. Plotësimi i pikës b) në nenin 6 të ligjit ekzistues. Shtimi në fund i fjalisë “si dhe të raportojnë rregullisht për shpenzimet e realizuara, duke i krahasuar me ato të planifikuara dhe duke evidentuar përmbushjen e treguesve gjinorë”, bëhet për t’u siguruar që planifikimi buxhetor realizohet me përgjegjshmëri dhe që raportohet në bazë treguesish, përfshirë edhe treguesit gjinorë. 16. Plotësimi i pikës c) në nenin 6 të ligjit ekzistues. Shtimi i togfjalëshit “(ligjore dhe në praktikë / de jure dhe de facto)” pas fjalës “mbrojtjen” bëhet për t’u siguruar që flitet jo vetëm për planifikimin e mbrojtjes së të drejtave në legjislacion e politika por edhe për sigurimin e zbatimit të tyre përmes masave e veprimeve përkatëse në strategji, plane, programe, projekte, etj. 17. Plotësimi i pikës 1/b) në nenin 7 të ligjit ekzistues. Shtimi i togfjalëshit “duke respektuar parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes”, bëhet për t’u siguruar që në këshillat vendorë rinorë do të zbatohet minimalisht parimi i përfaqësimit 50% me 50% i secilës gjini si dhe duke siguruar që brenda secilës gjini të ketë përfaqësim të bazuar te etnia, aftësia e kufizuar, vendbanimi, orientimi			
--	--	--	--	--

	seksual dhe shprehja e identitetit gjinor, etj. 18. Plotësimi i pikës 1/dh) në nenin 7 të ligjit ekzistues. Shtimi i togfjalëshit “të aksesueshme, të ndjeshme gjinore e gjithëpërfshirëse” bëhet me qëllim që infrastruktura rinore dhe hapësirat rinore të plotësojnë kriteret e barazisë gjinore, aksesueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes. 19. Plotësimi i pikës 1/e) në nenin 7 të ligjit ekzistues. Shtimi i togfjalëshit “duke zbatuar legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin”, bëhet me qëllim që në çdo strukturë të respektohen këto parime të rëndësishme. 20. Plotësimi i pikës 1/ë) në nenin 7 të ligjit ekzistues. Shtimi i fjalisë “si dhe raportimin rregullisht mbi shpenzimet e kryera, të krahasuara me parashikimin buxhetor dhe duke evidentuar përmbushjen e treguesve gjinorë” bëhet për t’u siguruar që planifikimi buxhetor nuk mbetet në letër, që zbatohen parimet e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe që treguesit, përfshirë edhe treguesit gjinorë, maten rregullisht. 21. Reformulimi i pikës 1/f) në nenin 7 të ligjit ekzistues. Reformulimi “f) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave të përditësuara rregullisht, të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera individuale, si dhe statistikave gjinore, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e njohjes, mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të të rejave dhe			
--	--	--	--	--

	të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, në territorin e tyre.”, bëhet për t’u evidentuar rëndësia dhe detyrimi i mbledhjes së të dhënave që përditësohen rregullisht, që ndahen sipas seksit dhe karakteristikave të tjera dhe që përpunohen së bashku me statistikën gjinore. Po kështu, të drejtat e të rejave dhe të rinjve duhet të njihen, mbrohen dhe zbatohen në praktikë. 22. Plotësimi i pikës 3, në nenin 7 të ligjit ekzistues. Shtimi i fjalisë “si dhe duke përdorur buxhetimin e përgjigjshëm gjinor si mjet për planifikimin e burimeve të nevojshme financiare, njerëzore e infrastrukturore për zbatimin e këtyre marrëveshjeve të përbashkëta”, bëhet me qëllim që të theksohet detyrimi për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, si dhe për të hartuar marrëveshje që të mund të zbatohen realisht në praktikë. Një marrëveshje, sidomos me karakter rajonal, nuk mund të jetë e zbatueshme nëse nuk planifikohen edhe burimet e nevojshme financiare për zbatimin e saj. Kjo gjithashtu nxit edhe për parashikimin e procedurave të cilat e mundësojnë dhe lehtësojnë zbatimin e marrëveshjeve të tilla, edhe në terma financiarë. 23. Plotësimi i pikës 2/b në nenin 8 të ligjit ekzistues. Shtimi i togefjalëshit “të përgjigjshme gjinore” bëhet për t’u siguruar që perspektiva gjinore integrohet në të gjitha programet dhe projektet rinore. 24. Plotësimi i pikës 2/d) në nenin 8 të ligjit ekzistues. Plotësimi me fjalinë “të cilat duhet të jenë të përditësuara rregullisht dhe të ndara			
--	---	--	--	--

	sipas seksit, moshës, aftësisë, etnisë, vendbanimit, orientimit seksuale e shprehjes së identitetit gjinor, si dhe karakteristikave të tjera individuale, për të cilat do të dakordësohet parimisht edhe me Institutin Kombëtar të Statistikave” bëhet me qëllim që baza e të dhënave të plotësojë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me mbajtjen dhe administrimin e të dhënave. 25. Plotësimi i pikës 2/e) në nenin 8 të ligjit ekzistues. Plotësimi me fjalinë “si dhe publikon raporte periodike, me të dhëna të ndara sipas karakteristikave të përcaktuara në pikën d) më sipër dhe me statistika gjinore e tregues gjinorë të matur në mënyrë progresive” bëhet me qëllim që së pari kjo pikë të diferencohet nga pika d) më sipër në të njëjtin nen dhe së dyti që të publikohen raporte të përditësuara, me të dhënat që mbledhen dhe analizohen. 26. Plotësimi i pikës 1 të nenit 9 në ligjin ekzistues. Para fjalës “ministrit” shtohet fjala “ministres” për të mundësuar përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore në ligj. 27. Plotësimi i pikës 1/a) në nenin 9 të ligjit ekzistues. Para fjalës “ministrit” shtohet fjala “ministres” për të mundësuar përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore në ligj. 28. Plotësimi i pikës 1/c) në nenin 9 të ligjit ekzistues. Plotësimi me togfjalëshat “të bazuar në analizën gjinore dhe vlerësimin e ndikimit gjinor” si dhe “duke u ndalur te përmbushja e treguesve të ndjeshëm gjinorë” bëhet me qëllim që të			
--	--	--	--	--

	theksohet domosdoshmëria e përdorimit të mjeteve të duhura që avancojnë integrimin gjinor në strategjitë e ndryshme të vendit. 29. Plotësimi i pikës 2 në nenin 9 të ligjit ekzistues. Plotësimi me fjalët e gjinisë femërore (si “ministrja” apo “anëtares”) si dhe me fjalinë “të cilat / cilët emërohen duke respektuar parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes” dhe “kanë një mandat dy vjeçar me të drejtë përsëritjeje edhe për dy vite të tjera”, bëhet së pari për të siguruar përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore në të gjithë ligjin; së dyti, për të respektuar kuotat gjinore sipas legjislacionit në fuqi, por edhe përfaqësimin e grupeve të ndryshme në këtë Këshill Kombëtar; së treti, për të qartësuar që pozicioni si anëtare / anëtar nuk mund të jetë i përjetshëm. 30. Plotësimi i pikës 1/a, në nenin 10 të ligjit ekzistues. Plotësimi me fjalinë “të cilat duhet të jenë të përgjigjshme gjinore dhe të miratuara në Këshillin Bashkiak, së bashku me kostot përkatëse të nevojshme për zbatimin e tyre” bëhet me qëllim që së pari të integrohet perspektiva gjinore dhe së dyti, planet përkatëse të jenë të miratuara së bashku me kostot e nevojshme për zbatimin e tyre. Procedura e miratimit në këshillin bashkiak mundëson edhe plotësimin e një sërë hapash në metodologjinë e përgatitjes së këtyre planeve, përfshirë edhe konsultimet me grupet e interesit dhe konsultimin publik. 31. Plotësimi i pikës 2 në nenin 10 në projekt-ligj. Plotësimi me fjalë			
--	--	--	--	--

	të gjinisë femërore, si dhe në fund me fjalinë “duke respektuar parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes” bëhet së pari që të mundësohet një ligj i shkruar me gjuhë të ndjeshme gjinore dhe së dyti, që të përfaqësohet në mënyrë të barabartë secila gjini, pa përjashtuar edhe diversitetin brenda secilës gjini. 32. Plotësimi i pikës c) në nenin 12 të ligjit ekzistues. Plotësimi bëhet për të shmangur abuzimin me fjalën “të kenë zbatuar” për 3 vite projekte, kur flitet për organizata të sapo themeluara. Mund të kërkohet një planifikim/parashikim i zbatimit të projekteve në tre vite. 33. Plotësimi i pikës 2/a të nenit 13/1 në projekt-ligj. Plotësimi me fjalinë “të përzgjedhur duke respektuar parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes” bëhet me qëllim që të evidentohet rëndësia e respektimit të ligjit për barazinë gjinore edhe në formimin e grupeve jo formale rinore. 34. Plotësimi i pikës 1 të nenit 14 në ligjin ekzistues. Plotësimi me fushat “shëndetësore, mjedisore, ekonomike, sportive, rekreative, shkencore, të komunikimit dhe digjitalizimit, etj.”, bëhet me qëllim që fushat e punës rinore të zgjerohen dhe përputhen me një sërë fushash të tjera në të cilat punohet dhe investohet në përputhje me programet e qeverisë por edhe në zbatim të dokumenteve ndërkombëtarë të ratifikuar. 35. Plotësimi i pikës 2 të nenit 14 në ligjin ekzistues. Plotësimi me fjalinë “ku njihet, pranohet dhe			
--	--	--	--	--

	respektohet barazia gjinore dhe drejtësia gjinore.” bëhet me qëllim që të theksohen barazia dhe drejtësia gjinore si çështje që karakterizojnë një shoqëri të zhvilluar. 36. Plotësimi i nenit 14/1 në projekt ligj. Fjalët e shtuara synojnë përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore. 37. Plotësimi i nenit 14/2 në projekt-ligj. Fjalët e shtuara synojnë përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore. Plotësimi i pikës 2 të këtij neni me “akomodimin” bëhet për të qenë të sigurt që të rejat dhe të rinjtë i kanë kushtet e nevojshme për kryerjen e praktikës së punës. Ndërsa shtimi i togfjalëshit “të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi” bëhet me qëllim që të mos abuzohet me “kontratat e përkohshme të punës” – term i cili është hequr qëllimisht dhe të mundësohet punësimi i të rejave dhe të rinjve sipas legjislacionit në fuqi. 38. Plotësimi i nenit 16 në ligjin ekzistues. Plotësimet e bëra synojnë gjuhën e ndjeshme gjinore dhe theksojnë nevojën për përgjigjshmëri gjinore dhe gjithëpërfshirje. 39. Plotësimi i nenit 17 në ligjin ekzistues. Plotësimet e bëra synojnë gjuhën e ndjeshme gjinore dhe theksojnë nevojën për përgjigjshmëri gjinore dhe gjithëpërfshirje. 40. Plotësimi i pikës 7, në nenin 17/1 të propozuar në projektligj. Plotësimi në tërësi në këtë nen bëhet me gjuhë të ndjeshme gjinore si dhe me qëllim që evidentimit të rëndësisë së zbatimit të standardeve të			
--	--	--	--	--

	aksesueshmërisë dhe të barazisë gjinore. 41. Plotësimi i pikës 2 të nenit 18 në ligjin ekzistues. Shtimi i një pike c) pas pikës 2/b) të këtij neni “c) të dhënat e cituara në pikat a) dhe b) më sipër, duhet të jenë të përditësuara rregullisht (çdo gjashtë muaj) dhe të jenë të ndara sipas seksit, moshës, etnisë, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, arsimit, e çdo karakteristike tjetër personale për të cilat dakordësohet paraprakisht me Institutin Kombëtar të Statistikave.”, bëhet me qëllim që, siç u shpjegua edhe më sipër, të dhënat të jenë të ndara dhe të përditësuara.			
14. Propozime të reja	14. “Neni 13/1” Grupet joformale rinore Në pikën 2 të nenit 13/1, sugjeroj të pasqyrohen edhe këto shtesa: - Përbërja e Grupit Rinor Joformal duhet të ketë të paktën 5 të rinj. Kjo sepse duke qenë se do zgjidhet një koordinator përfaqësues, duhet numri të jetë TEK, me qëllim që për çdo rast të mos krijohet konfuzion në përzgjedhje me shumicë votash. - Grupi Rinor Joformal duhet të ketë një kryesi që zgjidhet me mandat 1 vjeçar të rinovueshëm. Për grupet deri 10 anëtar, nuk ka kryesi por mjafton koordinatori. Për grupet 11 deri 20 anëtar, kryesia të ketë 3 anëtar përfshi edhe koordinatorin e zgjedhur. Për grupet mbi 20 anëtar, kryesia të ketë 5 anëtar përfshi edhe koordinatorin e zgjedhur. Gjykoj që numri maksimal i anëtarëve të mos	14. Propozime të ardhura në RENJK	14. Pranuar pjesërisht	14. Është shtuar përkufizimi i termit “grup joformal rinor” si një formë më e thjeshtuar dhe me më pak barriera e organizimit rinor, që do shërbejë për të nxitur më tej organizmin dhe aktivizimin e të rinjve në adresimin e problemeve komunitare, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe zonat rurale të vendit.

	lihet pa limit, por të jetë një shifër e pranueshme psh., deri 30 - 50 anëtar. Në të kundërt, nëse grupi sheh se duhet të zgjerohet më shumë, ai duhet tu nënshtrohet rregullave për regjistrim si Person Juridik. - Gjinia më pak e përfaqësuar duhet të ketë jo më pak se 1 anëtar, kjo sepse këto Grupe Rinore Joformale duhet që të jetë gjithpërfshirës dhe jo përjashtues për gjininë tjetër, sipas rastit, mashkull apo femër. - Në Aktin Noterial duhet të përmenden anëtarët përbërës të kryesisë së Grupit Rinor Joformal si dhe fusha/t specifike të veprimtarisë që ky grup do të kryejë. Këto të dhëna regjistrohen në Bazën e të Dhënave për Rininë. - Çdo ndryshim në përbërjen e kryesisë së Grupit Rinor Joformal dhe në veprimtarinë e tij, kryhet me Akt Noterial dhe këto ndryshime pasyrohen në rend historik në Bazën e të Dhënave për Rininë. - Grupi Rinor Joformal duhet të ketë një emër identifikues dhe, për aq sa është e mundur, të mos jetë i njëjtë me emra të ngjashëm. - Shpërbërja apo shpërndarja e Grupit Rinor Joformal bëhet me Akt Noterial dhe pasqyrohet në Bazën e të Dhënave për Rininë. - Kostoja e Akteve Noteriale për çdo veprim të këtij Grupi Rinor Joformal duhet të jetë fikse dhe minimale. 14.1 Disa propozime që mund të vijnë për draft ligjin e rinisë është që të kenë më shumë mbrojtje dhe edukime sociale! Qendra sociale rinore apo klube sportive, klube arti dhe Kulture.	14.1 Propozime të ardhura në RENJK	14.1 Pranuar pjesërisht	14.1 Në projektligj është parashikuar parimi i gjithëpërfshirjes. Të gjitha përcaktimet e
--	---	---	--------------------------------	--

	Të kenë me përparësi dhe sidomos në zonat rurale sepse janë të lëna shumë në harresë në çdo aspekt.			tjera do të detajohen me akte nënligjore pasi në ligj vendosen vetëm kriteret minimale.
--	--	--	--	--